

Lutja

O Zot Hyj, Ti shërbëtoreve tua Julës, Berchmanës, Krizinës, Antonijes dhe Bernadetës iu ke dhuruar hirin e thirrjes rregulltare dhe forcën që besnikërinë dhe dashurinë e vet ndaj Teje ta vulosin me gjakun e derdhur. Na dhuro edhe neve qëndresë në fe që as me çmim të vuajtjes të mos ndahemi prej teje.

Bëjë që Kisha shenjte t'ï ngritë këto shërbëtore të tua në nder të elterit, dhe që shembulli dhe ndërmjetësimi i tyre të na ndihmojnë në luftërat e jetës dhe në arritjen e shëlbimit të amshuar, nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Nëse dikush me ndërmjetësimin e Shërbëtoreve të Zotit i dëgjohet lutja, ose fiton ndonjë hirë, lusim le të lamërojë në një prej këtyre adresave:

Motrat Bijat e dashurisë Hyjnore
Binçë, Viti 61000 Kosovë

Motrat Bijat e dashurisë Hyjnore
Rruga: Lekë Dukagjini 34
Lagja: Vojo Kushi, Shkodër - Shqipëri

E-mail: kauza.dmukenice@gmail.com

Me lejën e Kishës



SHËRBËTORET E ZOTIT

m. M. Jula Ivanišević,
m. M. Berchmana Leidenix, m. M. Krizina Bojanc,
m. M. Antonija Fabjan, m. M. Bernadeta Banja

Bijat e dashurisë Hyjnore

Dëshmitaret e fesë

Motrat Bijat e dashurisë Hyjnore, në vitin 1911 kanë themeluar në Pale, jo larg prej Sarajevës, kuvendin „Shtëpia e Marisë“ vend për përmirësimin e shëndetit të motrave të sëmuara dhe për pushim të motrave mësimdhënëse në Institutin e shën Jozefit në Sarajevë. Shtëpia u bë e njohur përmes veprave të mira ndaj të gjithë nevojtarëve, sidomos ndaj ortodoksve, për këtë edhe është quajtur „Bujtina e të varfërve“.

Gjatë kohës së luftës, në vitin 1941, në atë bashkësi në Pale kanë jetuar eprorja m. M. Jula Ivanišević (kroate, 48 vjeçe), m. M. Berchmana Leidenix (austriake, 76 vjeçe), m. M. Krizina Bojanc (sllovene, 56 vjeçe), m. M. Antonija Fabjan (sllovene, 34 vjeçe) dhe m. M. Bernadeta Banja (kroate, me origjinë hungareze, 29 vjeçe). Me jetën dhe punën e tyre të suksesshme kanë dëshmuar dashurinë e krishterë në frymën e Kongregatës së tyre. Kanë mjekuar të sëmurët, ju kanë ndarë bukë fëmijëve prej shtëpisë shtetërore të fëmijëve duke mos bërë dallim ndaj fesë e kombit dhe kanë ndihmuar të varfërit. Por, më 11 dhjetor të vitit 1941, çetnikët të pesë motrat me dhunë i kanë dërguar në drejtim të Gorazhdës, kurse kuvendin e kanë vjedhur dhe e kanë djegur.

Rruga e tyre e Kryqit ka zgjatur katër ditë në të ftohtë dhe borë pa rroba të përshtatshme, ato kanë qëndruar ashtu në vuajtje duke i pyetur, kërcnuar dhe fyer. I dërguan së pari deri në Sjetlina, ku 76-vjeçarja m. Berchmana, e lodhur nga udhëtimi i gjatë dhe i pakëndshëm i rrugës, e ndarë prej motrave tjera është ndaluar aty. Të katër motrat tjera janë dërguar në Gorazhdë dhe janë vendosur në katin e dytë në repartin ushtarak. Në të njëjtën natë, më 15 dhjetor të vitit 1941, çetnikët kanë hyrë rrëmbyshëm tek motrat dhe i kanë sulmuar.

Duke e mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe duke e ruajtur pastërtin e kushtuar motrat kanë kërcyer nga dritarja, duke marrë shumë plagë. Duke e parë këtë çetnikët i kanë mbytur me thika dhe i kanë hedhur në lumin Drin.

Motër Berchmana ka mbetë dhjetë ditë në Sjetlina e robëruar, pastaj i kanë thënë se duhet të shkojë në Gorazhdë të motrat tjera, të cilat tashmë ishin të mbytura. Në kthimin e tyre, dy çetnikët të cilët e kanë përcjellur motrën, kanë thënë që ka arritur mirë të motrat e veta, kurse njëri prej tyre ka pasur në qaf rruazën e motrës Berchmana. Në fakt, ajo ishte vrarë më 23 dhjetor të vitit 1941.

Zëri i martirizimit të këtyre motrave, të njohura si Martiret e Drinit, është përhapur shumë shpejtë që prej fillimit. Procesi dioqezan për lumturimin e tyre është hapur në dhjetor të vitit 1999 në Sarajevë dhe ka përfunduar pas tri viteve me shumë sukses. Pastaj dokumentat janë dorëzuar në Kongregatën për kauzën e shenjtërve në Romë, ku procesi ka ecur përpara mirë. Shpresojmë që lumturimi i këtyre Shërbëtoreve të Hyjit motër Jula Ivanišević e katër bashkëmotrave tjera do të jetë jo vetëm njohje zyrtare e martirizimit të tyre, por edhe një promovim i vlerave shpirtërore për të cilat ato kanë jetuar dhe flijuar jetën e tyre.

Këto pesë motra janë shembull i veçantë i besnikërisë ndaj Hyjit dhe dashurisë ndaj të afërmit. Besojmë që gjaku i tyre i derdhur do të jetë fara e të krishterëve dhe thirrjeve të reja. Ato janë ndërmjetësuese të fuqishme në të gjitha nevojat, sidomos në prova të rënda dhe rreziqe të jetës. Shumë prej tyre janë vërtetuar. Lusim të gjithë të dëvotshmit e Martireve të Drinit të na bashkangjiten në uratë për shpalljen e lumturimit të tyre.